

# Mirësevini në Shqipëri

## IOM-i dhe OJF-të u ofrojnë migrantëve të kthyer

Asistencë për fillimin e një biznesi të vogël

Asistencë në arsimim, pagesa regjistrimi  
për studime dhe libra

Kualifikime profesionale në parukeri,  
hidraulikë, ndërtim etj.

Kurse gjuhësh të huaja dhe kompjuteri

Asistencë për punësim në ndërmarrje  
publike dhe private

Asistencë për komunitetin



**IOM Bonn**

Koblenzer Strasse 99  
53177 Bonn, Germany  
Tel: +49.228.82 09 40;  
Fax: +49.228.820 94 62  
IOM-Germany@iom.int  
www.iom.int

**IOM London**

21 Westminster Palace Gardens  
Artillery Row, London, UK  
SW1P 1RR  
Tel: +44 (0)20 7233 0001  
Fax: +44 (0)20 7233 3001  
ops@iomlondon.org  
www.iomlondon.org

**IOM Rome**

Via Nomentana 62  
00161 Rome, Italy  
Tel: + 39 0644 231 428  
Fax: + 39 0644 025 33  
MRFRRome@iom.int

**IOM Brussels**

40, Rue Montoyer  
1000 Brussels, Belgium  
Tel: + 32 2 282 45 60  
Fax: + 32 2 230 0763  
www.belgium.iom.int

**IOM Tirana**

Pruga Brigada e VIII, Vila nr.3  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 257 836/7  
Tel: +355 4 271 628  
Fax: +355 4 257 835  
iomtirana@iomtirana.org.al  
www.iomtirana.org.al

**IOM Skopje**

Antonije Grubisic No 5, 1000  
Shkup, Ish RJ e Maqedonisë  
Tel: + 389 2 328 9670  
Fax: + 389 2 328 9671  
IOMSkopje@iomskopje.org.mk  
www.iomskopje.org.mk

**IOM Pristina**

Ismail Qemali no. 18, Arbëri II  
Prishtinë , Kosovë  
Tel: +381 38 249 151/042  
Fax: +381 38 249 039  
IOMOPS@iom.ipko.org  
www.iom.ipko.org

**Shënim**

Opinionet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e IOM-it.

# IOM

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin është një nga organizatat ndërkombëtare kryesore që punon me migrantët dhe qeveritë për t'u dhënë përgjigje njerëzore sfidave të migracionit, përfshi edhe kthimin vullnetar dhe riintegrimin e asistuar në vendet e origjinës.

Për të ndihmuar në mënyrë të efektshme dhe të qëndrueshme migrantët që kthehen, nevojitet një rrjet i fuqishëm dhe i gjerë riintegrimi i strukturave që ofrojnë shërbime. Për këtë IOM nxit dhe mbështet përpjekjet për fuqizimin e sektorit të OJF-ve dhe shoqërisë civile në vendet e origjinës.

## Projekti

Kjo broshurë është hartuar në kuadrin e projektit "Nxitja e riintegrit të qëndrueshëm në Shqipëri, Provincën e Kosovës dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë duke forcuar kapacitetin e OJF-ve për të ofruar shërbime për të kthyerit", i cili financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet nga IOM. Ai synon të ndihmojë ata emigrantë nga Shqipëria, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë që bëjnë pjesë në një nga kategoritë e përmendura në vijim dhe që dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre të origjinës për shfrytëzuar mundësitë e mëtejshme ekonomike dhe arsimore. Personat që përfshihen në këtë projekt janë si vijon:

- Personat që u ka mbaruar viza
- Migrantët pa dokumenta
- Azilkërkesit të cilëve u është refuzuar azili

## Broshura

Kjo broshurë ofron informacion rreth mundësive të riintegrit në Shqipëri nga OJF-të lokale për personat që do të donin të ktheheshin nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia apo Belgjika dhe që dëshirojnë të planifikojnë kthimin dhe riintegrimin e tyre të suksesshëm.

Për informacione të mëtejshme për projektin dhe për shërbimet e ofruara ju lutemi lidhuni drejtpërdrejt me OJF-të ose me misionet e IOM-it në vendin e rezidencës (shiko faqen majtas).

Mirësevini në Shqipëri

# Shpresë për të Ardhmen



## Kush jemi ne?

Ne jemi një organizatë sociale me përvojë të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve të riintegritit për personat e kthyer. Projekti ynë kryesor "Kape të Ardhmen" vepron që në vitin 1999 dhe ofron shërbime riintegriti për azilkërkuesit që kanë dështuar në marrjen e azilit, për personat e riatdhesuar apo të kthyer vullnetarisht nga vendet e Evropës Perëndimore si edhe për migrantët e brendshëm.

## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Ne ndërmjetësojmë me punëdhënësit për mundësi punësimiti (në industri, ndërtim, etj);
2. Trainim profesional si kurse kompjuteri, kurse për gjuhë të huaja, trainim në fushën teknike;
3. Ndjekim në vazhdimësi dhe monitorojmë punësimet;
4. Informacion dhe këshillim mbi mundësitë e riintegritit;
5. Riintegrim social nëpërmjet këshillimit individual dhe takimeve të hapura për të kthyerit në të cilat diskutohen çështje të ndryshme (për shembull tregu aktual i punës).

### Si të lidheni me ne:

Bul. "Gjergj Fishta", Kulla Nr.8/Ap.11, Tiranë, Shqipëri  
Tel. +355 4 224033  
kape@albaniaonline.net

### Ku ndodhemi?

Në të gjithë Shqipërinë

sociale

# Shqipëri

# Agjensia Lokale e Zhvillimit Ekonomik



## Kush jemi ne?

Ne jemi një agjensi për zhvillimin ekonomik që ofron ndihmesë teknike dhe mbështetje me kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ne gjithashtu ndërmarrim analiza të tregut për mundësitë në sektorin e turizmit.

## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Nëse ju keni një plan biznesi, ne lehtësojmë mundësitë e kreditimit nëpërmjet sistemit bankar shqiptar;
2. Ndhmesë teknike për ngritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
3. Këshillim financiar dhe ligjor për bizneset;
4. Informacionin më të fundit lidhur me gjendjen e tregut të punës.

Mirësevini në Shqipëri

### Si të lidheni me ne:

L. 11 , Bulevardi Kryesor, pranë Kinema Iliria, Durrës  
Tel : + 355 52/24837; tauleda@hotmail.com

Bulevardi Vlorë- Skelë pranë Tirana Bank, Vlorë  
Tel:+355 33 22664, auledavlore@hotmail.com,

L. Qemal Stafa, Bulevardi "Zogu I", Shkodër  
Tel:+355 224/8702 teuleda@albnet.net

### Ku ndodhemi?

Në rrethet Durrës, Vlorë dhe Shkodër.

**biznesi**

# Intelektualët e Rinj, Shpresë



## Kush jemi ne?

Ne jemi një organizatë rinore që punon për zhvillimin shoqëror dhe për nxitjen e paqes dhe stabilitetit në vendet e Evropës Juglindore. Aktualisht, "Intelektualët e Rinj, Shpresë" administron edicionin shqip të faqes së internetit "One World (Një botë)", një rrjet i shoqërisë civile në Evropën Juglindore (<http://sq.oneworld.net>).

## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Informacion lidhur me tregun aktual të punës dhe mundësitë për punësim në Veriun e Shqipërisë;
2. Trainim në sektorë të ndryshëm si administrim për biznesin e vogël, të drejtat njerëzore të migrantëve, etj;
3. Kurse për kompjuter dhe gjuhë të huaja;
4. Ndërmjetësim për punësim në sektorin privat dhe publik.

### Si të lidheni me ne:

Lgj. "Qemal Stafa",  
Rr: "Daut Boriçi", 874, Shkodër  
Tel: +355 22 48476/48811/ 41229  
[irsh@albnet.net](mailto:irsh@albnet.net)

### Ku ndodhemi?

Në Veriun e Shqipërisë

rinore

# Shqipëri

# Shoqata e Grave Profesioniste dhe Afariste



## Kush jemi ne?

Ne jemi një organizatë që nxit rolin dhe imazhin e grave shqiptare në aktivitetet e biznesit në vend. Organizata vepron që në vitin 1995.

## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Ne ofrojmë punësim në sektorin privat dhe publik nëpërmjet ndërmjetësimit;
2. Trainim dhe orientim si të ngrini një ndërmarrje të vogël ose të mesme;
3. Trainim në administrim biznesi;
4. Ndërmjetësim me shoqëritë private për të lehtësuar trainimin në punë.

Mirësevini në Shqipëri

### Si të lidheni me ne:

"Rruga e Durrësit", Nr.36, Kati 2,  
Zyra 3-4, Tiranë  
Tel-Fax: + 355 4 2 357 26  
shgpa@icc-al.org

### Ku ndodhemi?

Në të gjithë Shqipërinë

a

promovim i gruas

# Forumi për Integrim Social, Kulturor dhe Ekonomik

## Kush jemi ne?

Ne jemi një organizatë që punon për integrimin social, kulturor dhe ekonomik të migrantëve të kthyer, në mënyrë të veçantë në pjesën jugore të Shqipërisë.



## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Ne ofrojmë informacion dhe lehtësim të trainimit për kompjuter,
2. Kurse për gjuhë të huaja, parukeri, administrim biznesi, etj;
3. Ndërmjetësim dhe lehtësim të punësimit në sektorin privat;
4. Lehtësim të trainimit në punë, në sektorë si rrobaqepsi dhe hidraulik.

### Si të lidheni me ne:

Rr. Gjik Kuçali, Pall.4/1  
Ap 13, Tiranë  
Tel: + 355 68 22 29 860  
Luan\_pogaci@yahoo.com

### Ku ndodhemi?

Në të gjithë Shqipërinë

Shqipëri  
kulturore, social, ekonomik

# Kryqi i Kuq Shqiptar



## Kush jemi ne?

Ne jemi një organizatë humanitare e cila ofron ndihmesë për të përmirësuar jetën e njerëzve të pambrojtur. Ne kryejmë operacione për të ndihmuar viktimat e katastrofave, të gërshetuara me punën për fuqizimin e kapaciteteve të anëtarëve të Kryqit të Kuq dhe shoqërive lokale.

## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Ne ofrojmë kurse trainimi për kompjuter, gjuhë të huaja dhe trainime të tjera profesionale si në rrobaqepsi;
2. Ndërmjetësim dhe lehtësim të punësimeve në sektorin privat;
3. Ofrojmë ndihmë ekonomike për familjet në nevojë;
4. Përgatitje dhe veprim në rast katastrofash;
5. Edukim të aftësive jetike për të rinjtë në disa rrethe të Shqipërisë;
6. Kurse trainimi të ndihmës së parë për publikun e gjerë;
7. Zbatim projektesh shëndetësore duke ofruar informacion dhe shërbime lidhur me higjenën në bashkësi, higjenën personale, parandalimin e HIV/SIDA-s, etj;
8. Riintegrim social, këshillim për migrantët e kthyer.

# Mirësevini në Shqipëri

### Si të lidheni me ne:

Kutia Postare 1511, Tiranë  
Tel/Fax:+355 4 225 855  
E-mail: [kksh@kksh.org.al](mailto:kksh@kksh.org.al)

### Ku ndodhemi?

Në të gjithë Shqipërinë


# a

# humanitare

# Qendra Rinore e Vlorës

## Kush jemi ne?

Ne jemi një organizatë rinore që mbështet dhe nxit zhvillimin e politikave rinore, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, integrimin social të grupeve të pambrojtura dhe nismat rinore. Ne ofrojmë shërbime për të integruar të rinjtë në punë, studime dhe shoqëri.



## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Ne ofrojmë këshillim mbi mundësitë për punësim;
2. Informacion për mundësitë publike ose private të trainimit si kurse kompjuteri, kurse financiare, etj;
3. Ne bëjmë studime të tregut dhe lidhje të kërkesës me ofertën;
4. Informacion rreth riintegrimin social dhe mundësive të arsimit në Shqipëri;
5. Informacion mbi investimet në ekonominë lokale; asistencë në hartimin e planeve të biznesit; informacion mbi sistemin e taksave dhe procedurat e licensimit; lehtësim të kontakteve brenda sistemit bankar në Vlorë;
6. Veprimtari sociale, kulturore, sportive, mjedisore dhe veprimtari të tjera promovionale.

### Si të lidheni me ne:

Pallati i Kulturës "Labëria, K II, Vlorë  
Qendra Tregëtare "Riviera", K II/ -05, Vlorë  
Tel/Fax: +355 33 29064  
E-mail: VYC@aul.com.al

### Ku ndodhemi?

Në rrethin e Vlorës

rinore

# Shqipëri

# Qendra për Mbështetjen e Migracionit



## Kush jemi ne?

Ne jemi një qendër mbështetëse për migrantët shqiptarë që kthehen nga vendet e Bashkimit Evropian. Ne ndërmarim studime dhe kërkime për migracionin dhe ofrojmë mbështetje për migracionin e ligjshëm, si edhe për riintegrimin ekonomik dhe social të migrantëve të kthyer.

## Çfarë mund t'ju ofrojmë?

1. Ne ofrojmë mundësi punësimi në bashkëpunim me Zyrat Rajonale të Punësimit dhe me sipërmarrësit;
2. Lehtësira dhe ndërmjetësim për trainimin në punë;
3. Këshillim për trainim profesional (në sektorë si ndërtimi, zdrukhtaria) për punëtorët e pakualifikuar;
4. Mbështetje me mikrokredi për ndërmarrjet e vogla në bujqësi, zejtarë, transport dhe turizëm nëpërmjet sistemit bankar shqiptar;
5. Trainim për ngritjen e ndërmarrjeve të vogla apo të mesme, përfshi edhe mbështetjen ligjore dhe ndihmesën për administrimin.

Mirësevini në Shqipëri

### Si të lidheni me ne:

Rr. Vllazën Huta, Tiranë  
Drejtoria Rajonale e Punësimit  
Tel/Fax: +355 4 363526;  
q.m.migracionit@icc-al.org

### Ku ndodhemi?

Në rrethet Tiranë dhe Durrës

## **Ekonomia**

Gjatë viteve të fundit, qëndrueshmëria ekonomike e Shqipërisë është rritur. Janë zhvilluar reforma strukturore për të përmirësuar zhvillimin e sektorit privat. Janë nënshkruar marrëveshje të tregëtisë së lirë me vendet e rajonit. Janë ndërmarrë privatizime të suksesshme si privatizimi i Bankës së Kursimeve të Shqipërisë nga Reiffeisen Group, dhe INSIG. Kjo është një provë që e ardhmja e sektorit financiar është një bazë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë.

Treguesit kryesorë ekonomikë dhe financiarë (burimi i informacionit: Qeveria e Shqipërisë) për vitin 2004 janë:

Prodhimi i brendshëm bruto (në milionë lekë)	822,677
Të ardhurat e përgjithshme (në milionë lekë)	85,916
Rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto në 2004 (në %)	6.0
Indeksi i çmimeve (në %)	-1.4
Deficiti i përgjithshëm (në milionë lekë)	-8,452
Niveli i papunësisë në % (Janar-Mars 2004)	14.9
Eksportet (në milionë lekë)	14,116
Importet (në milionë lekë)	48,530
Bilanci tregëtar	-34,414

Niveli zyrtar i papunësisë është ulur gjatë viteve të fundit dhe në "Strategjinë për Trainimin Profesional dhe Punësimin" është parashikuar krijimi i më shumë mundësive për punë dhe punësimi i qëndrueshëm. Kohët e fundit qeveria ka nxitur kthimin e të rinjve të kualifikuar, të cilët janë arsimuar jashtë vendit, për të punuar në administratën publike shqiptare. Gjithsesi, niveli i papunësisë si në zonat urbane edhe në ato rurale mbetet i lartë dhe ekonomia informale ka shtrirje të gjerë.

Po merren një sërë masash për të përmirësuar kushtet ekonomike: është rritur paga minimale, së bashku me përfitimet nga sigurimet shëndetësore dhe shoqërore; sektori i strehimit po përmirësohet; një sërë bankash japin kredi me interesa të përshtatshme në përputhje me rregullat e sistemit bankar, dhe gjithashtu jepen edhe kredi konsumatore. Krijimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme mbështetet plotësisht nga qeveria, shoqëria civile dhe bankat.

Megjithatë niveli i varfërisë në zona të caktuara rurale mbetet një shqetësim i rëndësishëm.

Sektori shëndetësor ofron shërbime dhe pajisje të reja dhe të përmirësuara në të gjithë vendin. Sistemi arsimor shënon përmirësimet më të mëtejshme: numri i studentëve të pranuar në universitete është rritur në krahasim me vitet e shkuara; programet shkollore janë rishikuar dhe përmirësuar në të gjitha nivelet arsimore. Gjithsesi, në të njëjtën kohë ekzistojnë ende shqetësime për cilësinë dhe shtrirjen e reformave arsimore në krahasim me vendet e tjera në tranzicion.

## **Infrastruktura: fakte dhe shifra**

Gjatë viteve të fundit janë ndërtuar ose përmirësuar rrugët Rrogozhinë – Elbasan, Lezhë – Shkodër, Shkodër - Mali i Zi, Lushnje – Fier, Tepelenë – Gjirokastrë, Vorë – Fushë Krujë, Elbasan – Librazhd.

Faza e dytë e rehabilitimit të portit të Durrësi do të nisë në vitin 2005, përfshi edhe një terminal të ri për udhëtarët. Paralelisht me këto zhvillime do të ndërmerrret edhe rindërtimi i rrjetit hekurudhor duke filluar nga Durrësi. Aeroporti ndërkombëtar "Nënë Tereza" është rehabilituar. Punimet për ndërtimin e një aeroporti të ri pranë Kukësit do të fillojnë në vitin 2005.

## **Zhvillimet ndërkombëtare**

- Hapja e bisedimeve me Bashkimin Europian (BE) në 31 janar 2004 për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit përbën një arritje të rëndësishme të qeverisë drejt integritit të Shqipërisë në BE;
- Qeveria ka ratifikuar kohët e fundit rreth 80 instrumenta ndërkombëtarë si traktate, marrëveshje, konventa dhe protokolle;
- Viti 2004 është quajtur nga qeveria si viti i reformave në çdo sektor që trajton lëvizjen e lirë të njerëzve në kuadrin e përafrimit të politikave të emigracionit shqiptar dhe lëvizjes së lirë me standartet e BE.

## **Situata politike**

Pjesëmarrja e partive politike në koalicionin



## IOM-i dhe OJF-të u ofrojnë migrantëve të kthyer

Asistencë për fillimin e një biznesi të vogël

Asistencë në arsimim, pagesa regjistrimi për studime dhe libra

Kualifikime profesionale në parukeri, hidraulikë, ndërtim etj.

Kurse gjuhësh të huaja dhe kompjuteri

Asistencë për punësim në ndërmarrje publike dhe private

Asistencë për komunitetin

